

## Korporata Energjetike e Kosovës .Sh.A.

### Përgjigje ndaj Raportit Konsultativ të ZRrE-së

Dorëzuar me 04 Mars 2011

#### I. Hyrje

Kjo është përgjigja e KEK-ut ndaj çështjeve të ngritura në Raportin Konsultativ (RK) të ZRrE-së të lëshuar me 22 Shkurt 2011. KEK-u pajtohet me ZRrE-në në shumë çështje, ndërsa për disa çështje tjera të rëndësishme për të cilat KEK-u nuk pajtohet me qëndrimin e ZRrE-së, i jep arsyetimet e veta për mospajtimet si dhe jep propozimet për përshtatje (rregullim).

#### II. Sqarimi i Kërkesës së KEK-ut dhe qëndrimin të ZRrE-së

##### a) Sqarimi i Të Hyrave të Lejuara

Për arsye të sqarimit dhe transparencës, KEK-u e ka përgatitur Tabelën A për të mundësuar një krahasim të qëndrimin të ZRrE-së me aplikacionin tariforë të KEK-ut për secilin përbërës të Të Hyrave të Lejuara. Në qëndrimin e ZRrE-së, vlerat janë ato të cilat janë përfshirë në Figurën 4 të Raportit Konsultativ. Përmbledhja e përfshirë në faqen 3 të RK tregon se ZRrE-ja mund të mos ketë marrur parasysh disa nga informatat e paraqitura në Aplikacionin Tariforë të KEK-ut. Për t'ju shmangur ndonjë dyshimi, Aplikacion Tarifor i KEK-ut i dorëzuar me 28 Janar mund të përmbledhet si në vijim:

Të Hyrat e Lejuara të Kërkuara	€197,696,000
Të Hyrat në Tarifatat Ekzistuese	€184,499,000
Rritja e Kërkuar Tarifore	€ 13,197,000
Përqindja e Kërkuar nga Tarifatat e Tanishme 7.15%	

Siç është shpjeguar në aplikacionin, Të Hyrat e Lejuara si dhe Të Hyrat me Tarifatat Ekzistuese kanë supozuar që Ferronikeli është konsumatorë për një vit të plotë me tarifën (4.2 Euro cent) të kërkuar nga KEK-u dhe me supozimin se aprovohen nga ZRrE-ja.

Krahasimet e përqindjes së ngritur me tarifatat mesatare duhet të bëhen duke analizuar nivelet e krahasueshme të kostos në raport me të hyrat relevante që dalin nga aplikimi i çmimeve ndaj niveleve të supozuara të shitjeve sipas kategorive të konsumatorëve (përcaktuesit e faturimit).

Tabela A paraqet Të Hyrat e Lejuara të kërkuara nga KEK-u (€197.7 milion) në krahasim me qëndrimin e ZRrE-së prej €184.6 milion të paraqitur në Figurën 4 të RK.

**Tabela A: Të Hyrave të Lejuara të Kërkuar nga KEK-u krahasuar me Qëndrimin e ZRrE-së**  
(Mijëra Euro)

**Analizat e KEK-ut krahasuar me pozitën e ZRrE-se në të Hyrat e Lejuara**  
(mijëra Euro)

<b>Pershkrimi</b>	<b>Aplikacioni KEK-ut</b>	<b>Azhustimet e ZRrE-se</b>		<b>Pozita e ZRrE-se</b>
		<b>Shuma</b>	<b>Referenca</b>	
SHPENZIMET e OPEX-it	98,863			98,863
Margjina e Furnizimit	5,359	(272)	Shenim 1	5,087
Shpenzimet per Borgj te Keq	5,000			5,000
Shpenzimet e Sigurimit per KEK Furnizim		(756)	Shenim 2	(756)
Zhvleresimi	15,392			15,392
KTHIMI	33,544			33,544
Importi	55,000	(4,886)	Shenim 3	50,114
Blerjet per Tension te Rrjetit	3,971			3,971
Alokimi Kostove te AQ	11,821	240		12,061
Export	(4,467)			(4,467)
Te hyra tjera operative	(1,500)	(1,600)	Shenim 4	(3,100)
Subsidy for Import	(35,000)	1,950	Shenim 5	(33,050)
Te hyrat nga Konsum. e Privilegjuar	0			0
<b>Azhustimet:</b>				
2010 CapEx-i Pashfrytezuar	(4,236)	(240)		(4,476)
2010 Importi Emergjent		(10,227)	Shenim 6	(10,227)
2010 Kostot e OPEX-it per V. te lumit Iber		(3,000)	Shenim 7	(3,000)
2010 Subvencioni Importit		10,979	Shenim 6	10,979
Cmimi pashpenzuar per License per 2010		(762)	Shenim 8	(762)
Interesi per azhustimet e pashpenzuara per 2010		(619)	Shenim 9	(619)
Tantiema e pashpenzuar per 2010		(114)		(114)
Cmimi KOSTT-it	19,755	(5,668)	Shenim 10	14,087
Shitje e Ene. ne KOSTT per Humbje	(5,806)	1,906	Shenim 10	(3,900)
<b>TOTAL TE HYRAT E LEJUARA</b>	<b>197,697</b>	<b>(13,068)</b>		<b>184,627</b>

**Shenim:**

- 1 Margjina e Furnizimit e zvogeluar nga ZRrE-ja per shkak te ndryshimeve ne koston e energjise
- 2 ZRrE-ja ka harruar te perfshije OPEX-in per koston e sigurimit ne koston e Furnizimit (mbikqyrje)
- 3 ZRrE-ja ka perjashtuar 1.7 milion te kerkuara per import emergjent dhe ka zvogeluar 53 GWH per humbje teknike me te ulta
- 4 ZRrE-ja ka supozuar qe Kosova B do ti marr 1.6 milion nga KOSTT-i per Sherbime Ndhimese - Nuk do te ndodhe
- 5 Vleresimi rishikuar per subvencion bazuar ne draftin me te fundit te Bugjetit te Kosoves (Bugjeti ende nuk eshte finalizuar)
- 6 ZRrE-ja eshte duke rimbursuar mbivleresimet per 2010 per import te energjise dhe subvencionet ne lidhje me Qeveri
- 7 ZRrE-ja eshte duke rimbursuar lejimet e 2010 per koston e OPEX-it per rreg. e sherb.ne V. te lumit Iber, e cila nuk ka ndodhur
- 8 ZRrE-ja ka azhustuar te Hyrat e Lejuara te KEK-ut per Cmimin e pashpenzuar te Licensave (ne ZRrE) gjate vitit 2010.
- 9 ZRrE-ja ka shtuar intersin prej 8.15% ne rimbursimet per lejimet e pashpenzuara per 2010
- 10 ZRrE-ja ka azhustuar te Hyrat e Lejuara te KEK-ut per cmime ne lidhje me transmisionin dhe te hyrave per KOSTT

**b) Sqarimi i Bilancit Energjetik**

ZRrE-ja i ka paraqitur detajet e Bilancit Energjetik në Figurën 1 të RK. Në përgjithësi, ZRrE-ja i ka paraqitur saktësisht numrat e energjisë në Aplikacionin e KEK-ut. Tabela B më poshtë jep krahasimin mes qëndrimit të KEK-ut dhe të ZRrE-së, me shpjegimet e Përshtatjeve (rregullimeve) të ZRrE-së, sa i përket asaj që KEK-u mund të përcaktoj nga RK.

Është shumë e rëndësishme që të sqarohen dallimet dhe të jepet një transparencë, në veçanti sa i përket “Humbjeve politike” (energjisë së pa-faturuar të furnizuar në Veri të Lumit Iber). Edhe pse KEK-u nuk ka ndonjë kundërshtim serioz ndaj shumicës së përshtatjeve të ZRrE-së, ne jemi të shqetësuar se pse ZRrE-ja e ka ndryshuar Bilancin Energjetik të cilin e kanë aprovuar me 15 Nëntor 2010 dhe ka zvogëluar Humbjet Komerciale në nivele jo reale. Shiko çështjen A në pikën III për diskutimin e kësaj çështje me rëndësi.

## Tabela B: Krahasimi i Bilancit Energjetik - KEK dhe ZRrE

### Bilanci Energjetik 2011

Energji ne GWH

	Aplikacioni		Azhustimet e ZRrE-se		Pozita
	KEK-ut	Shuma	Referenca	ZRrE-se	
KEK Gjenerimi	4,768	(15)	Shenim 1		4,753
Blerjet nga Ujmani	82				82
Importi	893	(53)	Shenim 1		840
Eksporti	194				193
<b>Total Furnizimi ne Transmision</b>	<b>5,549</b>	<b>(68)</b>			<b>5,482</b>
Humbjet ne Transmision	172	(41)	Shenim 2		131
Shitjet ne Transmision	768	5	Shenim 3		773
Konsumi Intern	126				126
Hidrocentralet tjera	43				43
<b>Hyrja ne Distribucion</b>	<b>4,526</b>	<b>(32)</b>			<b>4,495</b>
Humbjet Teknike ne Distribucion	797	(28)	Shenim 4		769
Humb. Komer.(vjedhja me se shumti)	825	(115)	Shenim 5		710
Ener. e pafat.ne Veri te lumit Iber	189				189
Teprica/Mungesa	(2)				
<b>Shitjet ne Distribucion</b>	<b>2,713</b>	<b>115</b>			<b>2,828</b>
<b>Energjia</b> Ferronikeli	678				678
<b>Faturuar</b> Sharr & Trepca	90	5	Shenim 3		95
Konsumatoret Distributiv	2,713	115	Shenim 5		2,828

ZRrE-ja ka shtuar Humbjet Politike ne Veri tek Humbjet Komercciale **Total = 899**

#### Shenim:

- 1 KEK gjenerimi dhe importi jane zvogeluar per shkak te azhustimeve te ZRrE-se per humbje teknike te Transmisionit dhe Distribucionit.
- 2 Humbjet ne Transmision te zvogeluara nga ZRrE-ja ne 2.3%
- 3 Eshte e pakjarte pse ZRrE-ja ka shtuar 5 GWH per Birren e Pejës ( konsumator distributiv 35 KV ) tek shitjet ne nivel te transmisionit
- 4 Humbjet Teknike ne Distribucion te zvogeluara nga ZRrE-ja prej 17.6% ne 17.1%
- 5 ZRrE-ja ka zvogeluar humbjet komerciale nga Bilanci Energjetik i aprovuar per 2011 dhe ka vene diferencen ne shitje

Edhe pse KEK-u nuk ka ndonjë vërejtje të madhe ndaj ZRrE-së për zvogëlimin e lejuar të humbjeve teknike në Distribucion, ne dëshirojmë të theksojmë se ngritja e humbjeve teknike mund të jetë e pritshme për shkak të ngarkesës së konsiderueshme në rrjetin elektrik për shkak të mosfunksionimit të Termokosit.

### III. Komentet e KEK-ut ndaj Qëndrimit të ZRrE-së

#### a) Pikat e Marrëveshjes së Përgjithshme

KEK-u është në pajtim me ZRrE-në në shumicën e këtyre çështjeve të cilat ata i kanë ngritur edhe në përshtatjet që kanë dal nga kjo. Për shembull, përshtatjet (rregullimet) për subvencionin e importit për vitin 2010 për energjinë e importuar të pa harxhuar, janë të arsyeshme. Poashtu, reduktimet për taksat e transmisionit për vitin 2011 të bazuara në reduktimet e pritura të tarifës së KOSTT-it janë bazuar në informatat e reja dhe azhustimet janë të përshtatshme. Përshtatjet tjera të vogla për Margjinën e Furnizimit, Kostot e Alokuar për Administratën Qendrore, dhe disa ndryshime të pashpjeguara nuk janë duke u kontestuar nga KEK-u. Përshtatja e €762,000 për taksën e pa-shfrytëzuar të Licencës së ZRrE-së për Gjenerimin në 2010 është e arsyeshme për faktin se KEK-u i ka paguar më pakë ZRrE-së

ZRrE pohon se nuk lejon një pjesë të kostos për energjinë e importuar për faktin se KEK-u nuk ka dhënë një shërbim 24 orësh për konsumatorët në kategorinë e reduktimeve A dhe B. KEK-u kurrë nuk është zotuar për të mos pasur reduktime për kategoritë A dhe B. Siç e din ZRrE-ja, reduktimet janë të nevojshme për të balancuar furnizimin dhe kërkesën. Ka disa raste,

veçanërisht në dimër, kur do të ishte jo-ekonomike për të blerë energji të shtrenjtë emergjente për periudha të shkurta kohore, kështu që, reduktimi i konsumatorëve në kategorinë B është shpesh i kërkuar dhe konsumatorët e kategorisë A jo shpesh reduktohen për të balancuar furnizimin dhe kërkesën në përgjithësi dhe për të parandaluar tej-ngarkesën e panevojshme të daljeve në ndonjë rajon. Një çështje shumë e rëndësishme në Prishtinë që nga Tetori i vitit 2010 është ngritja e konsiderueshme për kërkesën e energjisë elektrike që shkakton mbingarkesë në sistemin e distribucionit të KEK-ut për shkak të mosfunksionimit të Termokosit. KEK-u nuk ka pritur që të ndodhë një gjë e tillë dhe nëse një gjendje e tillë vazhdon edhe në sezonin e ardhshëm, ndërprerjet për shkak të mbingarkesës si dhe kostoja e mirëmbajtjes do të ngritet. KEK-u do të donte që ZRrE-ja të pranojë se reduktimet në vitin 2010 kanë qenë në nivelin më të ulët në 10 vitet e fundit për të gjitha kategoritë e konsumatorëve. Përqindja e kërkesës së pa shërbyer për shkak të reduktimeve ka qenë 3.4% në vitin 2010 në krahasim me 6.9% në vitin 2009 dhe 12.8% në vitin 2008, që paraqet një përmirësim të dukshëm. Për më tepër, informatat që i janë dhënë ZRrE-së tregojnë se shumica e reduktimeve janë bërë në daljet e kategorisë C.

KEK-u e falënderon ZRrE-në për përfshirjen e një lejimi për shpenzimet e borxhit të keq në Të Hyrat e Lejuara për të parën herë. Kërkesa e KEK-ut prej €5 milionëve e që është aprovuar nga ZRrE-ja është shumë e kujdesshme (25% nga përvoja aktuale në vitin 2010).

## **b) Përshtatjet e Kontestuara nga KEK-u**

Disa ndryshime të bëra nga ZRrE-ja janë kontestuar dhe KEK-u kërkon që ZRrE-ja të konsideroj secilën nga çështjet e paraqitura më poshtë dhe të bëjë përshtatjet (rregullimet) në Të Hyrat e Lejuara të Propozuara nga ZRrE-ja. Secila nga ato çështje është paraqitur më poshtë.

### **ÇËSHHTJA A: Reduktimet e Paarsyeshme në Humbjet Komerciale**

Gjatë përgatitjes së Bilancit Energjetikë për vitin 2011, janë bërë disa korrigjimi në bazë të diskutimeve mes KEK-ut dhe ZRrE-së. KEK-u e ka përgatitur Bilancin Energjetik duke u bazuar në llojshmërinë e supozimeve dhe shqyrtimit të situatës së tanishme. Humbjet Komerciale (poashtu të referuara si Energji e Pa-llogaritur dhe që fillimisht përbëhet nga vjedhjet e konsumatorëve, të regjistruar dhe të pa-regjistruar) janë paraparë të jenë përafërsisht 20% nga hyrja në sistemin e shpërndarjes. Për referencë, kostot aktuale komerciale për vitin 2010 kanë qenë 913 GWH që paraqesin 20% të hyrjes në shpërndarje.

Në rastin e ZRrE-së vlerësimi i humbjeve komerciale për vitin 2011 është zvogëluar në 18%. ZRrE-ja ka dhënë arsyetimin se Ligji i ri mbi Energjinë (Nr. 03/L-201) përmbajnë dispozita në nenin 39 për dënime të dukshme për vjedhjen e energjisë. Derisa mbetet të shihet se si prokuroret dhe gjykatat do i zbatojnë dispozitat e ligjit të ri, KEK-u ka shprehur gatishmëri të rishikojë vlerësimin e humbjeve komerciale në 18%. KEK-u e ka bërë këtë korrigjim në Bilancin Energjetikë dhe e ka dorëzuar atë te ZRrE-ja dhe KOSTT-i duke supozuar që është finalizuar.

Me 15 Nëntor KEK-u ka pranuar njoftimin nga ZRrE-ja që thoshte se “Bordi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë në seancën e mbajtur me 11 Nëntor 2010 e ka dhënë aprovimin e Bilancit të Energjisë për vitin 2011 me disa vërejtje që sugjerojnë se humbjet komerciale dhe energjia në enklava nuk duhet të kaloj vlerën 20.1% të energjisë së hyrë në shpërndarje”. KEK-u ka supozuar se bilanci energjetikë ishte aprovuar derisa KEK-u e ka dorëzuar atë dhe “sugjerimi” ka qenë si koment e jo mandat që zyrtarisht të bëhen ndryshime. Nëse ZRrE-ja ka pasur si qëllim që të bëhen ndryshime, pse nuk i kanë korrigjuar numrat? KEK-u i është përgjigjur atij njoftimi përmes e-mailit duke falënderuar ZRrE-në për aprovimin e Bilancit Energjetik dhe dha fakte të qarta që tregojnë se të dhënat më të fundit treguan se humbjet komerciale ishin 20% dhe energjia e furnizuar në Veri të Lumit Ibër ishte 4%. Kjo tregon se zvogëlimi i për 4 përqind nga ato vlera ishte jo

real. Kjo është e dukshme veçanërisht pasi që KEK nuk ka kontroll ndaj energjisë së furnizuar në nivelin 110KV nga KOSTT-i në nënstacionin e Vallaçit në Veri, i cili nuk kontrollohet nga KEK-u. Çdo zvogëlim në ato humbje duhet të bëhet në humbjet komerciale në pjesën e shërbimeve të KEK-ut. Një zvogëlimi prej 2 përqindësh veç ishte bërë dhe një zvogëlim tjetër shtesë prej 2 përqindësh nuk është i arsyeshëm.

KEK-u kërkon që ZRrE-ja të eliminoj zvogëlimin arbitrar (dhe të paarrtshëm) që e bëri në humbjet komerciale dhe të përdor vlerën 18% të humbjeve komerciale që përfshirë në Bilancin Energjetik, e cila paraqet një përmirësim të dukshëm mbi nivelin e tanishëm prej 20%

#### **ÇËSHTJA B: Heqja e Kostos së Sigurimit për Furnizimin e KEK-ut**

Me 2 Mars, ZRrE-ja i dha KEK-ut një kopje të modelit tariforë që ZRrE-ja e përdori për të zhvilluar vlerat që ata i përdorën për të përcaktuar të hyrat e lejuara në Raportin Konsultative. Shqyrtimi që KEK-u i bëri modelit tariforë, tregon se ZRrE-ja ka dështuar të fus një vlerë në celulën për koston e shërbimit të sigurimit për Divizionin e Furnizimit. KEK supozon se kjo ka qenë thjesht një mos vëmendje pasi që ZRrE-ja nuk i ka zvogëluar kostot e sigurimit për asnjë divizion tjetër të KEK-ut dhe në përgjithësi nuk ka pasur kundërshtim ndaj vlerave të përgjithshme për shpenzimet e OPEX. KEK supozon që ZRrE-ja do të përmirësojë këtë anashkalim dhe të ngrisë të Hyrat e Lejuara përfundimtare në shumë prej €756,000 për këtë shpenzim të nevojshëm.

#### **ÇËSHTJA C: Përfshirja e Të Hyrave për Shërbimet Ndhmëse nuk do të realizohet**

ZRrE-ja i ka zvogëluar Të Hyrat e Lejuara të KEK-ut për €1.6 milion në pritje të Pagesës që KOSTT-i do i bëjë KEK-ut për Shërbimet Ndhmëse në pajtueshmëri me një draft kontrat që akoma nuk ka hyrë në fuqi. KEK plotësisht i mbështet përpjekjet e KOSTT-it që t'ia mundësoj Kosovës që të bëhet një rajon i kontrollit dhe qëllimi i kontratës është që të bëhet një hap në atë drejtim. Çmimi në këtë kontratë nuk është aprovuar akoma nga ZRrE-ja dhe një treg i shërbimeve ndhmëse nuk ekziston akoma dhe nuk ka ndonjë datë të planifikuar për implementim në vitin 2011. ZRrE-ja akoma nuk e ka aprovuar çmimin e kontratës; kështu që, përshtatja nuk është adekuate pasi që KOSTT-i nuk do e bëjë këtë pagesë. ZRrE-ja inkurajohet të marrë parasysh këtë fakt në zhvillimin e tarifave të KOSTT-it.

#### **ÇËSHTJA D: Përshtatja për OPEX-in e Pa harxhuar për vitin 2010 në Veri të Lumit Ibër**

Shqyrtimi tariforë 2010 supozonte se gjatë vitit 2010 KEK-u do të jetë në gjendje që të vendosë rolin e vetë si Operatori i vetëm i Sistemit të Shpërndarjes dhe Furnitorit Publik në veriun e Kosovës dhe do të rregulloj konsumatorët si konsumatorë të KEK-ut. Komuniteti ndërkombëtar nuk ka e ka mundësuar atë iniciativë dhe që prej Marsit 2011 rregullimi akoma nuk ka ndodhur. Në shqyrtimin tariforë 2010, ishin supozuar shitje të konsumatorët në Veriun e Kosovës (për të krijuar të hyra) dhe ZRrE-ja ka lejoj €3 milion në të Hyrat e Lejuara për OPEX për distriktin e ri (€2 milion për Rrjet dhe €1 milion për Furnizim. Në llogaritjet e të Hyrave të Lejuara për 2011, ZRrE-ja e bënë një përshtatje për të kompensuar OPEX-in e pa shpenzuar të vitit 2010 prej €3 milion plus kamatën. KEK-kërkon që ZRrE-ja të heq këtë përshtatje (rregullim) pasi që e trajton vetëm njërin aspekt të situatës (koston) derisa e injoron faktin se shitjet e supozuara në Kosovën Veriore nuk janë materializuar. Natyrisht, shitjet e porealizuara në Veri të lumit Ibër e lënë anash OPEX-in e pa shpenzuar. Për këtë arsye, ZRrE-ja inkurajohet që të rris të Hyrat e Lejuara me €3,245,000 (€3 milion plus kamatën me 8.15%).

#### **ÇËSHTJA E: Vonesa për Aprovimin e Tarifës së Rregulluar për Shërbimin në 220KV**

Me 06 Dhjetor 2010, KEK-u ka dorëzuar një aplikacion te ZRrE-ja për shqyrtimin dhe aprovimin e një tarife të rregulluar për konsumatorët që shërbehen në 220 KV. Siç është shpjeguar në aplikacion, posa të ketë skaduar kontrata me Ferronikelin, KEK-u do të lejohet t'i shërbej Ferronikelit sipas licencës së Furnitorit Publik si konsumatorë i rregulluar. Në Letrën Konsultative, ZRrE-ja me korrektësi e citon nenin 18.6.2 të Ligjit mbi Energjinë Elektrike që është i aplikueshëm në këtë situatë, por e keqinterpreton pozitën e KEK-ut duke thënë se KEK-u si Furnitori Publik refuzon t'i shërbej Ferronikelit. Faktet janë shumë të qarta dhe mund të përmbliken si në vijim:

- KEK-u i ka informuar ZRrE-në dhe Ferronikelin se dëshiron që t'i shërbej Ferronikelit si Furnitor Publik
- KEK-u si Furnitor Publik është i ndaluar me ligj që t'i shërbej Ferronikelit me ndonjë tarifë tjetër pos asaj që është aprovuar nga ZRrE-ja.
- KEK-u i ka dorëzuar ZRrE-së një aplikacion të hollësishëm tariforë para tre muajve dhe poashtu i ka dhënë ZRrE-së draft kontratën që duhet të hyjë në fuqi në Prill 2011 për t'i shërbyer këtij konsumatori.
- Është e domosdoshme që ZRrE-ja të vendosë për tarifen e rregulluar për 220KV para fundit të Marsit 2011 në mënyrë që ruaj këtë ngarkesë të madhe. Humbja e kësaj ngarkes nga KEK-u do kërkonte që të gjitha tarifat tjera të konsumatorëve të ngriten pasi që të Hyrat nga Ferronikeli kontribuojnë ndryshëm për të mbuluar kostot fikse të KEK-ut.
- KEK-u as nuk do të/dhe as që i kërkohet t'i shërbej Ferronikelit sipas Licencës së tij të Tregtimit. Kjo nënkupton se nëse ZRrE-ja nuk e aprovon tarifën e rregulluar, Ferronikeli do të jetë i shtrënguar të bëjë prokurimin e energjisë elektrike jashtë Kosovës.

ZRrE-ja inkurajohet që të aprovoj tarifën 220 KV dhe ta paraqes atë në vendimin tarifor të caktuar për datën 23 Mars. KEK-u do vazhdoj në supozimin se Ferronikli do të bëhet konsumatorë i rregulluar në Prill 2011 me ngarkesën e supozuar në Bilancin Energjetik 2011 (fuqia 90 MW dhe 678,287 MWH të konsumit) dhe tarifën e rregulluar si në vijim:

Pagesa fikse	1,000 Euros në Muaj
Pagesa e Fuqisë së kontraktuar	13.00 Euros për KW të Fuqisë së kontraktuar
Pagesat mujore të energjisë	2.09 Euro cent për all kWh
Mbingarkesa	26.00 Euros/KW për secilin KW më tepër se Fuqia q Kontraktuar

### c) Llogaritja e Ndryshimit të Kërkuar në Tarifat e Pakicës

Nëpër tërë Raportin Konsultativ, ZRrE-ja ka përdorur çmimet e ndryshme mesatare për 2010 dhe 2011 dhe përdor normat e atyre mesatareve për të përcaktuar se sa duhet të ndryshojnë tarifat. Është me rëndësi të theksohet që ZRrE-ja ka dal me një konkluzion të pasaktë se diferenca mes Të Hyrave preliminare të Lejuara nga ZRrE-ja (€184 milion) dhe të Hyrave sipas tarifave Ekzistuese (€184 milion) bazuar në përcaktuesit e faturimit është €16.5 milion. Ekzistojnë ndryshime të dukshme në përzierjen e shitjeve mes 2010 dhe 2011, fillimisht për shkak të faktit se shitjet te Ferronikeli janë përfshirë në përcaktuesit e faturimit në vitin 2011 por jo në vitin 2010. Pasi që ato shitje janë paralogaritur me 20% nga shitjet e përgjithshme të rregulluara në vitin 2011, derisa ato paraqiten me zero në vitin 2010, përdorimi i mesatareve të kombinuara nuk është adekuat.

Table nr.2 në aplikacionin e KEK-ut për tarifa tregon qartë se mesatarja aktuale e tarifës është 5.30 Euro cent, duke konsideruar që Ferronikeli është konsumatorë i rregulluar. Kjo

tarifë mesatare siguron € 184.5 Milion të të hyrave. Figura 7 në RK përmban një tarifë mesatare prej 5.59 cent e cila është e pasaktë, që rezulton në një mbivlerësim në vlerë prej €16.5 Milion të të hyrave tarifore ekzistuese në vlerë prej €201 milion.

ZRrE-ja inkurajohet të krahasoj Të Hyrat e Lejuara për vitin 2011 me tarifën ekzistuese duke përdorur përcaktuesit e faturimit për të caktuar shumën dhe përqindjen përmes të cilave ndryshimet tarifore janë të nevojshme.

#### d) Llogaria Balancuese e Tarifave

ZRrE-ja ka prezantuar konceptin e “Llogarisë Balancuese të Tarifave” (LBT) në RK-të saj. KEK-u nuk ka ndonjë vërejtje të caktuar në konceptin e LBT-së; megjithatë ne inkurajojmë ZRrE-në të përpilojë një dokument të caktuar të parametrave për përdorimin e një mekanizmi të tillë. KEK-u shpreh gatishmërinë që të punojë së bashku me ZRrE-në në përpilimin e këtij mekanizmi.

KEK-u ka një shqetësim serioz që ZRrE-ja ka përshtypjen se LBT-ja do të fillon me një bilancë në vlerë prej €16.5 Milion. Siç përshkruhet në Pikën III c më lartë, bilanci fillestar do të ishte zero bazuar në të hyrat e lejuara të propozuara nga ZRrE-ja prej €184 milion krahasuar me të hyrat e tarifave ekzistuese në vlerë prej €184 Milion.

### IV. Të Hyrat e Lejuara të Propozuara Rritja e Kërkuar Tarifore – të Përshtatura (rregulluara)

Bazuar në pesë çështje të rëndësishme të ngritura në Seksionin III më lartë, KEK-u i kërkon ZRrE-së që të korrigjoj Të Hyrat e Lejuara që të pasojnë me ngritjen tarifore siç është paraqitur në Tabelën C më poshtë.

#### Tabela C: Të Hyrat e Lejuara dhe Ngritja e Kërkuar Tarifore

(mijëra euro)

##### **2011 Të Hyrat e Lejuara:**

Të Hyrat e Lejuar nga ZRrE-ja sipas Letrës Konsultative	184,626
Përshtatja në bazë të çështjeve kryesore të ngritura:	
Kostot e Sigurimit për Kostot e Divizionit të Furnizimit (çështja B)	756
A/S të Hyrat që nuk do të realizohen (çështja C)	1,600
OPEX-i i pa shpenzuar në Veri të Lumit Ibër për 2010 (çështja e D)	3,245
<b>Të Hyrat e Lejuar të Korrigjuara</b>	<b>190,227</b>
<b>2011 Të Hyrat sipas Tarifave të Tanishme</b>	<b>184,499</b>
<b>Rritja e Kërkuar në Tarifa</b>	<b>5,728</b>
	<b>3.1%</b>

Shënim: KEK-u pret që ZRrE-ja do të përdorë përcaktuesit e faturimit të cilët i ka dorëzuar KEK-u në aplikacionin e tij tariforë me shitjet për konsumatorët e rregulluar prej 3,481 GWH (2,713 në shpërndarje dhe 768 në nivelin e transmisionit). Kjo është në pajtueshmëri me çështjen A, se zvogëlimi në shitje (115 GWH) në lidhje me azhustimin e humbjeve komerciale nuk është bërë.

Siç e ka cekur ZRrE-ja në Letrën Konsultative, Buxheti i Konsoliduar i Kosovës nuk është finalizuar akoma. Në rast se subvencioni final në buxhet për importet e energjisë elektrike ndryshon nga €33,050,000 të supozuara më lartë, kërkohet një përmirësim që të korrespondoj me këtë.

ZRrE-ja deklaron në RK se struktura ekzistuese tarifore do të mbetet e pandryshuar. KEK-u brengoset që kjo implikonë që nuk do të ketë lëvizje drejt tarifave kosto reflektuese. Siç ka rekomanduar KEK në aplikacionin e vet tarifor, meqenëse tarifat e Amvisërsisë janë nën kostot e shërbimit, do të duhej të kishte një lëvizje graduale në drejtim të mbulimit të koston. Në rast se ZRrE-ja pranon një ngritje të përgjithshme të tarifave prej 3.1% siç është diskutuar më lartë, atëherë KEK-u rekomandon që tarifat e amvisërisë të ngriten për më shumë se 3% dhe klasat tjera tarifore të ngriten për më pak se 3%.